



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 03.06.2019

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM EKONOMIK (OECD), PËR BËRJEN PALË NË KUADRIN GJITHËPËRFSHIRËS TË PROJEKTIT NDËRKOMBËTAR MBI EROZIONIN E BAZËS SË TATUESHME DHE TRANSFERIMIN E FITIMIT (BEPS)”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 03.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi Erozionin e Bazës së Tatueshme dhe Transferimin e Fitimit (BEPS)”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten znj. Aurora Mara.

Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishte i pranishëm z. Erjon Luçi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS)”.

Kjo marrëveshje ka për qëllim pjesëmarrjen e Shqipërisë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS)”, duke i mundësuar që të punojë në mënyrë të barabartë me vendet e tjera anëtare në trajtimin e shmangies tatimore, në përmirësimin e koherencës së rregullave të marrëveshjeve tatimore dhe në sigurimin e një ambienti tatimor sa më transparent.

Ky projekt ofron për vendin tonë, sikurse dhe për të gjitha vendet e tjera pjesëmarrëse:

- zhvillimin e standardeve në lidhje me çështjet e BEPS-së;
- rishikimin dhe implementimin e standardeve minimale nëpërmjet një sistemi efektiv monitorimi;
- një forum për vendet që të nxjerrin në pah sfidat në zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe të gjejnë zgjidhje të reja;
- lehtësimin e procesit të implementimit duke ofruar orientim të mëtijshëm dhe suport për vendet në zhvillim, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve dhe drejtimin sipas platformës së bashkëpunimit për tatimet, e ngritur kjo nga organizatat ndërkombëtare.

Duke qenë pjesë e kuadrit gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar BEPS, vendet anëtare marrin angazhimin për sa i përket plotësimit të standardeve minimale të paketës BEPS, e cila në total përmbledh 15 plane veprimi. Kjo paketë i pajis shtetet pjesëmarrëse me instrumente vendase dhe ndërkombëtare për të adresuar shmangien e taksave, në mënyrë që fitimet të tatohen aty ku kryhen aktivitetet ekonomike që i gjenerojnë ato dhe aty ku krijohet vlera.

Për bërjen palë të Republikës së Shqipërisë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe shmangien e fitimit (BEPS), do të paguhet një kuotë anëtarësie prej 20 200 eurosh në vit, vlerë e cila do të rregullohet dhe me inflacionin vjetor përkatës nga ana e OECD-së.

Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin nr.628, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave dhe është nënshkruar më 28.05.2019 në hapjen e takimit të 7-të të kuadrit gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit, të mbajtur në Paris. Projektligji parashikohet të hyjë në fuqi pas ratifikimit/pranimi nga palët pjesëmarrëse në përputhje me procedurat e tyre të brendshme.

III. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORE

KRYETAR

AURORA MARA

ULSI MANJA